



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 371 Prot.

Tiranë, më 17.02.2026

V E N D I M

Nr. 34, Datë 17.02.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 27 Regj., datë 22.01.2026, paraqitur nga z. M. A. M. M, në të cilën pretendon diskriminim nga: subjekti privat “Mobileri Tani dhe Edi Bajraktari” shpk, kompania “Nubia” (me seli në Egjipt), Kompania Wlaa - Shqipëri, Kompania Sofian - Shqipëri, Kompania Saif - Shqipëri, shtetasit M. dhe E - Recruit Albania, për shkak të “ngjyrës, gjendjes ekonomike, gjendjes shoqërore, përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues parashtron si më poshtë citohet: *“Duket qartë se praktika e sjelljes së punëtorëve egjiptianë nga Egjipti, nëpërmjet kontratave të punës dhe ndërmjetësve që veprojnë në Shqipëri është kthyer në një fenomen të rrezikshëm që i ngjan tregtisë së qenieve njerëzore.*

Kjo praktikë përbën shkellje të rëndë të të drejtave të njeriut, cenon dinjitetin njerëzor dhe shfrytëzon gjendjen ekonomike të punëtorëve, të cilët detyrohen të emigrojnë në kërkim të një jete më të mirë.

Në rastin konkret, punëtori egjiptian M. A. M. M ka qenë viktimë e mashtrimit dhe shfrytëzimit. Pas mbërritjes në Shqipëri nuk i është ofruar punësim real apo mundësi për të gjetur një kontratë të re pune, duke i mbajtur dhe dokumentet personale.

Janë zhvilluar komunikime dhe biseda ndërmjet tre palëve: punëtorit, Kompanisë “Nubia” në Egjipt, dhe personave ndërmjetësues në Shqipëri, të cilët kanë ushtruar presion psikologjik, kërcënime dhe shantazh financiar.”

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht: *“Hapjen e një hetimi administrativ të plotë; Ndërprerjen e çdo forme kërcënimi dhe shfrytëzimi; Marrjen e masave ligjore ndaj personave dhe subjekteve përgjegjëse; Mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të punëtorëve të huaj në Republikën e Shqipërisë.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoj se kjo ankesë duhej plotësuar, fillimisht me elementët formal, sipas kërkesave ligjore respektive.

Për këtë arsye, inspektori i çështjes me email-in datë 28.01.2026, iu drejtua personit që kishte depozituar ankesën në emër të ankuesit, në të cilin, ndër të tjera, iu kërkuar që të dërgonte një deklaram të thjeshtë me shkrim, të firmosur prej subjektit ankues, nëpërmjet të cilit shpreh vullnetin të përfaqësohet pranë Komisionerit nga z. M. H, si dhe të depozitojë formularin e ankesës drejtuar KMD-së, të nënshkruar prej tij.

Në vijim të njoftimit të mësipërm, përfaqësuesi i subjektit ankues, pranë KMD-së, nuk e plotësoi ankesën me dokumentacionin e kërkuar, pavarësisht afatit kohor të lënë në dispozicion.

Në ankesën objekt shqyrtimi z. M. H, pretendon se shtetasi egjiptian M. A. M. M po diskriminohet për shkak të cituara prej tij.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi*

i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e racës, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, afhtësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht

nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Bazuar në nenin 4, të LMD, përcaktohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”*

Sipas nenit 32, të LMD, përcaktohet se: *“ 1. Komisioneri ka kompetencë:a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri” ;.....3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Referuar nenit 33, të LMD, përcaktohet se: *“ 1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”.*

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”*

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Bazuar në nenin 4, të LMD të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t'i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/1/a dhe 33/1, të LMD, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që z. M. H të legjitimohet si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë, që në rastin në fjalë nuk dëshmohet, pasi pretendimi i z. M. H, lidhet me prezuminin e tij se shtetasi egjiptian M. A. M. M është diskriminuar si pasojë e mashtrimit dhe shfrytëzimit. Pas mbërritjes në Shqipëri nuk i është ofruar punësim real apo mundësi për të gjetur një kontratë të re pune.

Bazuar në aktet e administruara, Komisioneri konstaton se, përsa më sipër, mbështetur në nenin 64¹, paragrafi 1 dhe nenin 65² paragrafi 1, i Kodit Civil, z. M. H, që të jetë përfaqësues ligjor I shtetasit egjiptian M. A. M. M, duhet të legjitimohet të përfaqësojë atë, duke kërkuar në emër dhe me vullnetin e tij të shprehur pranë Komisionerit, që ky i fundit të hetojë për diskriminimin e pretenduar kundrejt tij.

Në respektim të parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 33, pika 1 citohet: *“Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal”*, z. M. H duhet të legjitimohet për përfaqësimin e shtetasit egjiptian M. A. M. M pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi³.

Përsa më sipër dhe në kushtet kur z. M. H, nuk legjitimohet për të përfaqësuar subjektin ankues pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

¹ Neni 64, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Me përfaqësimin, një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)”.

² Neni 65, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuar i caktohen me prokurë”

³ Për analogji citojmë vendimin nr. 118, datë 29.06.2021 dhe nr. 87, datë 14.04.2025, të KMD-së.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të LMD-së, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga z. H. M, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

Pavarësisht konstatimit të bërë më sipër lidhur me mungesën e legjitimitetit të z. M. H, për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi në emër të shtetasit egjiptian M. A. M. M, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, shtetasi egjiptian M. A. M. M, në ankesën e depozituar pranë KMD-së, pretendon se, ka qenë viktimë e mashtrimit dhe shfrytëzimit. Pas mbërritjes në Shqipëri nuk i është ofruar punësim real apo mundësi për të gjetur një kontratë të re pune, duke i mbajtur dhe dokumentet personale. Z. M pretendon se gjatë komunikimeve dhe bisedave ndërmjet tij, Kompanisë “Nubia” në Egjipt, dhe personave ndërmjetësues në Shqipëri (duke përfshirë këtu: subjektin privat “Mobileri Tani dhe Edi Bajraktari” shpk, Kompaninë Wlaa - Shqipëri, Kompaninë Sofian - Shqipëri, Kompaninë Saif - Shqipëri, shtetasit M. B dhe E - Recruit Albania) ndaj tij është ushtruar presion psikologjik, kërcënime dhe shantazh financiar.

Veprimet e pretenduara nga ankuesi konsistojnë në si më poshtë citohen:

- *Se ka qenë viktimë e mashtrimit dhe shfrytëzimit;*
- *Se pas mbërritjes në Shqipëri nuk i është ofruar punësim real apo mundësi për të gjetur një kontratë të re pune, duke i mbajtur dhe dokumentet personale;*
- *Se ndaj tij është ushtruar presion psikologjik, kërcënime dhe shantazh financiar;*
- *Se nënshkrimi i kontratave fiktive të punës ngre dyshime për shfrytëzim e trafikim të qenieve njerëzore, duke shfrytëzuar nevojat ekonomike”.*

Nisur nga sa më sipër, lidhur me ngjarjen objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuesit lidhen me veprime dhe sjellje që, nëse provohen, mund të përbëjnë elementë të kundërvajtjeve apo veprave penale. Për rrjedhojë, vlerësimi i ekzistencës së përgjegjësisë penale, si dhe ndjekja penale e subjekteve të përfshira, nuk hyn në kompetencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por është atribut i organeve të ndjekjes penale, konkretisht i Prokurorisë, si organi kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale.⁵

Bazuar në sa më sipër, në analizë të legjislacionit penal shqiptar, Komisioneri evidenton si vijon:

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcaktojnë se: “*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën,*

⁴ Për analogji citojmë vendimet: nr. 240, datë 27.11.2018, nr. 134, datë 16.05.2024 dhe nr. 138, datë 16.05.2024, të KMD-së.

⁵ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale...*”

mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht se: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprahe, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

Kodi penal, në nenet poshtë cituar, parashikon se:

Neni 110/a, - *“Trafikimi i personave të rritur”, përcakton se: “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

...Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”

Nenet vijuese 110/b⁶ dhe 110/c⁷ kanë penalizuar përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar si dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin.

⁶ Neni 110/b - *“Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar”, përcakton se: “Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”.*

⁷ Neni 110/c - *“Veprimet që lehtësojnë trafikimin”, përcakton se: “Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet...”*

Për rrjedhojë, nisur nga konsiderimi në tërësi, i gjithë sa më sipër, Komisioneri vëren se, hetimi i veprimeve, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se mund të përbëjnë elementë të veprës penale, nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së⁸.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse: ... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja b), nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 27 Regj., datë 22.01.2026, të shtetasit egjiptian M. A. M. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁸ Për analogji citojmë vendimet: nr. 22, datë 19.01.2024, nr. 218, datë 05.08.2024, nr. 85, datë 14.04.2025, etj, të KMD-së.